



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1423 / prot.
2

Tiranë më 26.12.2017

REKOMANDIM

Nr. 59, datë 26.12.2017

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Baza Ligjore: Ligji Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, nenet 30, 31 dhe 32 të tij.

Ligji Nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*".

Në zbatim të Urdhrit nr. 275 datë 25.10.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (I.E.V.P.) "*Fier*" me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të I.E.V.P. "*Fier*".

Institucioni i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale "*Fier*" është institucion varësie i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe ka për qëllim garantimin e masave të sigurisë, realizimin e trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve, zbatimin e programeve të rehabilitimit dhe rinte grimit, zbatimin e politikave shëndetësore si dhe detyrimet e tjera që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. I.E.V.P. "*Fier*" është kategorizuar si institucion paraburgimi dhe burg i sigurisë së zakonshme.

Drejtoria e Hetimit Administrativ, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e I.E.V.P. "*Fier*", të cilët ishin njohur me Urdhrin e Komisionerit për kryerjen e hetimit administrativ.

Gjatë hetimit administrativ të ushtruar dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga përfaqësuesit e I.E.V.P. "*Fier*", është konstatuar:

1. Në dosjet e personelit civil dhe të punonjësve të policisë së burgut konstatohet se ka dokumenta të tepërta referuar nenit 17 të Ligjit nr. 10032 datë 11.12.2008 "*Për Policinë e Burgjeve*", nenit 27 të Rregullores "*Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e*

masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve" miratuar me Urdhrin nr.3125/1 datë 04.09.2009 të Ministrit të Drejtësisë. Dokumenta të tepërta janë: dokument me të dhëna "sensitive" të nëpunësit "Çertifikata shëndetësore për punonjësit" e detajuar (me të dhëna të tilla si grup gjaku, kqyrje fizike, ekzaminime laboratorike etj), "Dëshmi Penaliteti", "Masa Disiplinore" (përtej afatit të parashikuar në nenin 70 pika 5 të Rregullores), etj.

Konstatimi përbën shkelje administrative të Kreut II (Përpunimi i të dhënave personale) të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

2. Nga verifikimi i ambienteve në të cilat I.E.V.P. "Fier" ushtron aktivitetin si hyrjet, ambienti i vizitorëve, korridoret e administratës etj., është konstatuar se ato janë të mbikëqyrura nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV). Gjatë verifikimit në vend, është konstatuar se disponohen rregullore, udhëzime dhe procedura të mirëfillta për sistemin e video-vëzhgimit (CCTV) pavarësisht se të dhënat "imazhe-video" nuk trajtohen në kuadër të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Zyra e Komisionerit ka konstatuar se I.E.V.P. "Fier" informon nëpërmjet tabelave subjektet e të dhënave "vizitorë" dhe "punëmarrës", mbi përpunimin e të dhënave personale "imazhe-video" me anë të sistemit të Video-Vëzhgimit (CCTV), ndonëse ato nuk janë sipas modelit standard të miratuar nga Zyra e Komisionerit.

Zyra e Komisionerit ka miratuar nëpërmjet Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" modelin standard të tabelës informuese, duke ju vënë në dispozicion kontrolluesve një mekanizëm standard për t'ju mundësuar subjekteve të të dhënave informimin mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit CCTV si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre në raste cënimi.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të Ligjit: "Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij."

3. I.E.V.P. "Fier" nuk disponon Rregullore "Për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale" miratuar me Urdhrin nr. 496 datë 28.09.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar: "2/1. Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregulloret e tjera."

4. Një pjesë e arshivës së dosjeve të të paraburgosurve dhe të burgosurve ndohet në zyrën e drejtorisë juridike në raftë të hapur dhe të aksesueshme fizikisht dhe pa masa shtesë sigurie.

Zyra e Komisionerit konkludon se kontrolluesi nuk ka marrë masa të përshtatshme për të kufizuar aksesin nga personel i paautorizuar në dosjet e të paraburgosurve dhe të burgosurve.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar.

5. Nga verifikimi i dokumentacionit personal të punësimit të personelit civil dhe policor, është konstatuar se I.E.V.P. *"Fier"* nuk ka marrë masa për *"ruajtjen e konfidencialitetit"* nga punëmarrësit të cilët, për shkak të detyrës dhe përkrahimit të pozicionit të punës, kanë akses në mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit ka miratuar nëpërmjet Vendimit nr. 6 datë 05.08.2013 *"Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale"* modelin standard të *"Deklaratës së Konfidencialitetit"*, duke u mundësuar kontrolluesve një mekanizëm për të angazhuar nëpunësit në *"ruajtjen e konfidencialitetit"* në lidhje me të dhënat që ata aksesojnë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar: *"Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj"*.

Konstatimet e mësipërme në tërësinë e tyre përbëjnë tejkalim të mbledhjes së informacionit të kërkuar në zbatim të Ligjit nr. 10 032/2008 *"Për policinë e burgjeve"*, Rregullores *"Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve"* miratuar me Urdhrin nr.3125/1 datë 4.9.2009 të Ministrit të Drejtësisë, Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24 të Komisionerit datë 27.12.2012 *"Për detyrimet e kontrolluesve përpara se të përpunojnë të dhëna personale"*.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit ka mbajtur procesverbalin të cilin e lexoi në prani të përfaqësuesit të I.E.V.P. *"Fier"*, i cili e nënshkroi duke mos paraqitur pretendime.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"* dhe në respektim të së drejtës për tu dëgjuar sa i përket shkeljeve të konstatuara, Zyra e Komisionerit ka organizuar një seancë dëgjimore në të cilën është ftuar I.E.V.P. *"Fier"* dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si organ epror. Deri në ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore I.E.V.P. *"Fier"* nuk kishte rikuperuar shkeljet e konstatuara.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit mban në konsideratë faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e kontrollit gjatë hetimit administrativ.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 5, 6, 18, 27, 28, 29, 30, 31 dhe 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi I.E.V.P. "Fier", në zbatim të nenit 5 dhe 6 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të përditësojë ku është e nevojshme dhe të rikthejë subjekteve të të dhënave "punëmarrës" dokumentat e tepërta të cilat ndodhen në dosjet personale të tyre, në mënyrë që përmbajtja e dosjeve të jetë në përputhje me parashikimet në nenin 17 të Ligjit nr. 10032 datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve" dhe nenit 27 të Rregullores "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve" miratuar me Urdhrin nr.3125/1 datë 04.09.2009 të Ministrisë të Drejtësisë.
2. Kontrolluesi I.E.V.P. "Fier", në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të standartizojë tabelat informuese për subjektet e të dhënave në lidhje me informimin mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre në raste cënimi, sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri nëpërmjet Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera";
3. Kontrolluesi I.E.V.P. "Fier", në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar të marrë masa të përshtatshme për zbatimin e Rregullores "Për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale" miratuar me Urdhrin nr. 496 datë 28.09.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve;
4. Kontrolluesi I.E.V.P. "Fier", në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar të marrë masa të përshtatshme për të kufizuar aksesin nga personeli i paautorizuar në dosjet e të paraburgosurve dhe të burgosurve.
5. Kontrolluesi I.E.V.P. "Fier", në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të marrë masa për ruajtjen e konfidencialitetit nëpërmjet nënshkrimit të "Deklaratës së Konfidencialitetit" nga punëmarrësit të cilët, për shkak të detyrës dhe përshkrimit të pozicionit të punës, kanë akses në mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
6. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, I.E.V.P. "Fier" të kryejë plotësimin e detyrimeve të parashikuara në këtë Rekomandim brenda afatit 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni, dhe të njoftojë me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për masat e marra. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit.
7. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i

ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 26.12 2017

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

